

**A. TERMAT E REFERENCËS**  
**Për hartimin e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave,**  
**Bashkia Vorë**

**1. HYRJE :**

Bashkia Vorë është administratore dhe menaxhuese e fondit pyjor e kullosor që shtrihet në territorin e saj. Mbështetur kjo në Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 3.3.2021 Disa ndryshime në vendimin Nr. 433, Datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe Kullotave Publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshura, Shtojca 52. Në bazë të ligjit të pyjeve qeverisja teknike e sektorit të pyjeve dhe kullotave bëhet sipas planeve të mbarështrimit, të cilat duhet të sigurojnë masa për :

- a) Zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtarë, ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore për gjallesat pyjore dhe komunitetin e tyre.
- b) Mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve silvikulturore e të punimeve të tjera, të cilat kanë për qëllim sigurimin e funksioneve ekologjike dhe shoqërore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, vjeljen e prodhimeve pyjore dhe përdorimin e fondit pyjorë kombëtarë, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimeve pyjore, të burimeve të tjera dhe të gjeneratës së re të masivit pyjor.
- c) Mbarështrimin e pyllit dhe të tokës pyjore ,për të ruajtur funksionet e tyre, shkallën e ruajtjes së mjedisit pyjor dhe të ripërtëritjes natyrore
- d) Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore e natyrore të ngastrave e ekonomive pyjore, në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të gjallesave pyjore dhe të komuniteteve të tyre.

Plani i mbarështrimit për ekonominë pyjore “Vorë” dhe Prezë”, synon të zhvillojë një plan gjithëpërfshirës të menaxhimit për sipërfaqen pyjore që shtrihet në këto ekonomi pyjore, duke mbuluar por pa u kufizuar domosdoshmërisht në aspekte të ndryshme fizike, sociale, ekonomike dhe ekologjike të zonës, duke sugjeruar mënyrat e duhura/rekomandimet për të adresuar zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor mbi bazën aktuale ligjore, administrative, etj. Bazë për një planifikim të suksesshëm është edhe puna e madhe si ekip midis pylltarëve lokale dhe stafit të specialistëve të mbarështrimit. Për mbarështrimin shumë funksional e të qëndrueshëm, afat shkurtër dhe afatgjatë të pyllit nevojiten të dhëna për gjendjen aktuale të tij.

Meqënë se ngastra ose nënngastra është njësi bazë me e vogël për vlerësimin e planifikimin, kontrollin epërshkrimin dhe analizimit të kushteve të stacionit dhe grumbujve pyjore, përcaktimi i objektivave dhe masave specifike përveç inventarizimit është një nga detyrat kryesore për mbarështrimin e suksesshëm të pyllit.

## 2. DETYRAT KRYESORE:

- Marrja e të dhënave nga kadastra për gjendjen e fondit pyjor ,punimet e kryera ndër vite,fotokopjimi dhe zmadhimi i hartës në 1 :10 000, hedhja e kufijve të ngastrave mbi bazën e ndarjes në planet e mbarështrimit të vitit 1981 dhe të vitit 2002
- Përshkrimi i përgjithshëm në terren i ngastrave/n.ngastrave,verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren,përcaktimi i sipërfaqeve sipas përdoruesve, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse.
- Përcaktimi i sipërfaqeve provë në terren dhe inventarizimi për çdo sip.provë, llogaritja e diametrit mesatar (dm) dhe lartësia mesatare (hm)
- Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellesie (çdo 200 ha)
- Marrja e drureve model për çdo lloj, tip dhe thellësi toke, për përcaktimin e saktë të moshës për çdo diametër e lartësi mesatare.
- Studimi social-ekonomik i Njësisë Administrative
- Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes;
  - i.Trungishte
  - ii.Cungishte
  - iii.Shkurre
- Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe ato mbajtes.
- Vlerësimin e llojshmerise dhe sasive se prodhimeve jo-pyjore (prodhime të dyta).
- Identifikimi i problematikes lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve;
- Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë;
- Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zones;
- Explorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zones;
- Hartografimi i territorit të zones (në GIS), duke përfshirë;
  - i. Ekonomite pyjore, pjesët ekonomike, ndarjen parcelare, n/parcelare, llojet pyjore dhe format e qeverisjes.
  - ii. Përdorimin e territorit të zonës.
  - iii. Masat e propozuar të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve.
  - iv. Rrjetin e përhershëm, të përkohshëm të sipërfaqeve provë.
- Ngritjen e një sistemi të përhershëm sipërfaqesh prove për matjen (dhe me tej monitorimin periodik)dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të Mbarështrimit.
- Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonomite pyjore
- Hartimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe plani i veprimit;
- Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që pritet të zhvillohen në zone .
- Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kopjuterik i tyre .
- Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara;
- Diskutimi i draft-planit të menaxhimit me Aktoret vendimarrës (Bashkia Vorë, Ministria e Mjedisit, Njësitë Administrative, OJF, etj).
- Recensime të draft-planit të përgatitur.
- Ripunim material pas vërtetimit të bera dhe miratimi përfundimtar nga komisioni

### **3. OBJEKTIVI KRYESOR**

*Të sigurojë menaxhim të qendrueshëm të resurseve pyjore/kullusore bashkiake (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukture dhe cilesi të mirë në pershtatje me kushtet e stacionit dhe në përputhje me objektivat e mbareshtrimit. Mbareshtrimi i pyjeve është konsideruar të jetë një input i rëndësishëm për aktivitetin ekonomik, social dhe mjedisor e shoqërisë dhe e vendit në teresi.*

### **4. OBJEKTIVAT SPECIFIKE**

- Të përcaktohet përdorimi i territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat.
- Të optimizojë formën e qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.
- Të optimizojë funksionet ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
- Të përmirësojë ose mirembajë në një gjendje të mirë funksionale grumbujt pyjorë.
- Të përmirësojë përdorimin e prodhimtarisë së stacionit në pyjet me funksion prodhues.
- Të përmirësojë cilësinë dhe gjendjen e pritshme të grumbujve të trungishteve me funksion prodhues
- Të nxisë dhe perdore ripërteritjen natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të rikrijohet ekosistemi pyjorë që i pershtaten mjedisit
- Të pakësojë impaktet negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve.
- Të pakësojë prerjet e paligjshme
- Të rehabilitojë dhe të sigurojë rritje të qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullusore.
- Të sigurojë pjesëmarrjen e gjërë e popullsisë lokale në marrjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave
- Të zhvillojë menaxhimin e pyjeve bashkiake duke lidhur resurset pyjore/kullusore me interesat e përdoruesve .

### **5. PRODUKTET**

- Një plan gjithëpërfshirës i menaxhimit për ekonomitë pyjore në fjalë që mbulon, por nuk kufizohet në sfondin / kontekstin; Arsyetimin / justifikimin;
- Një vizion i qartë mbi burimet natyrore, misionin, qëllimin dhe objektivat menaxhuese të ekonomive pyjore;
- Objektivat kryesore të menaxhimit, strategjitë, rekomandimet dhe aktivitetet e propozuara të menaxhimit
- Një plan i detajuar operacional së bashku me buxhetin dhe planin e punës për dhjetë vitet e ardhshme;
- Një plan i plotë monitorimi, lehtësisht i kuptueshëm dhe me seri të plotë të treguesve të progresit, efektet dhe ndikimet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave përkatëse së bashku me kalendarin kohor të tyre.
- Plani i mbareshtrimit, së bashku me anekset përkatëse të tij si dhe hartat tematike (të pershkruarame sipër) në 3 (tre kopje) të printuara (në shkallë 1:25.000), si dhe formati dixhital i të gjitha të dhënave të grumbulluara/përpunuara në CD. Një përmbledhje e planit të menaxhimit si dhe aktivitetet e propozuara për t'u zbatuar në këtë ekonomi pyjorë si dhe legjenda e hartave tematike duhet të jenë në gjuhën shqipe.

Ne menyre me te detajuar dhe pergjithesisht plani i mbareshtimit duhet te permbaje :

## 1. HYRJE

- 1.1 Arsyet dhe objektivat e planit të mbarështrimit.
- 1.2 Detyra e projektuesit
- 1.3 Radha e operacioneve dhe përgjegjësitë.
- 1.4 Metodatat e Punës.
- 1.5 Materiali informativ i përdorur
- 1.6 Objektivat kryesore të mbarështrimit
- 2 PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË
- 2.1 Shënime të përgjithshme
- 2.2 Pronësia, administrimi, organizimi
- 2.3 Historiku i mbarështrimit
- 2.4 Gjendja e përgjithshme social-ekonomike
- 2.5 Gjendja ekologjike

Sipërfaqet pyjore jane me potencial te mire prodhues.

- 2.6 Gjendja e tregut te materialeve drusore dhe jo drusore
- 2.7 Kufizimet
- 2.8 Gjuetia dhe peshkimi

## 3 GJENDJA AKTUALE E PYLLIT

- 3.1 Mbarështrimi dhe funksionet
  - 3.1.1 Tipet e përdorimit të tokës
  - 3.1.2 Forma e qeverisjes
  - 3.1.3 Funksionet kryesore
  - 3.1.4 Ndarja e pyjeve
- 3.2 Përshkrimi i stacionit
  - 3.2.1 Klima.
  - 3.2.2 Topografia
  - 3.2.3 Faktorët edafikë
- 3.3 Biodiversiteti
  - 3.3.1 Shkalla e natyralitetit të pyllit
  - 3.3.2 Biotopet e veçante
  - 3.3.3 Habitatet specifike
  - 3.3.4 Llojet e kërcenuara
  - 3.3.5 Rreziqet për biodiversitetin
  - 3.3.6 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështrim
- 3.4 Funksionet e veçanta aktuale
  - 3.4.1 Prodhimi
  - 3.4.2 Mbrojtja
  - 3.4.3 Ruajtja e natyrës
  - 3.4.4 Rekreacioni
  - 3.4.5 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështrim
- 3.5 Analiza e grumbullit
  - 3.5.1 Analiza e tipit të grumbullit
  - 3.5.2 Të dhënat kryesore për n/ngastër
  - 3.5.3 Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit
  - 3.5.4 Rezultatet e inventarizimit
  - 3.5.5 Analiza silvikulturale
  - 3.5.6 Intesiteti i ndërhyrjeve
  - 3.5.7 Struktura e grumbulli
  - 3.5.8 Ripërtëritja natyrale
  - 3.5.9 Cilësia e lëndës në këmbë

- 3.5.10 Rritja
- 3.5.11 Krahasimi i grumbullit me “pyllin normal”
- 3.6 Gjëndja fitosanitare
  - 3.6.1 Drurë të kalbur dhe shkaqet
  - 3.6.2 Dëmtimet në pyll
  - 3.6.3 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështrimin
- 3.7 Prerjet ilegale
  - 3.7.1 Gjendja aktuale
  - 3.7.2 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështrimin
- 3.8 Bimësia barishtore
- 3.9 Kullotat
  - 3.9.1 Tipi dhe cilësia
  - 3.9.2 Përdoruesit/koha
  - 3.9.3 Prodhimi i biomasës
  - 3.9.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti
  - 3.9.5 Problemet (mbikullotja, kullotja ilegale ne pyje etj)
  - 3.9.6 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështrim
- 3.10 Gjahu dhe gjuetia.
- 4 VLERËSIMI I MBARËSHTRIMIT TË MËPARSHËM
  - 4.1 Të përgjithshme
  - 4.2 Vlerësimi i zbatimit të masave të planifikuara
    - 4.2.1 Masat silvikulturale
    - 4.2.2 Mundësia e shfrytëzimit
    - 4.2.3 Krite të tjera
    - 4.2.4 Pasojat kryesore për mbarështrimin e ardhshëm dhe arritjen e objektivave 33
- 5 OBJEKTIVAT E MBARËSHTRIMIT
  - 5.1 Objektivat kryesore
  - 5.2 Objektivat specifike për ekonominë pyjore
    - 5.2.1 Përdorimi i territorit, forma e qeverisjes, funksionet
    - 5.2.2 Tipi i grumbullit
    - 5.2.3 Objektivat silvikulturale
    - 5.2.4 Kullotat
    - 5.2.5 Biodiversiteti dhe habitatet kryesore të flores dhe bimesise se zones, bazuar ne kategorizimet e Natura 2000 .
    - 5.2.6 Gjëndja shëndetsore/Prerjet ilegale
    - 5.2.7 Mbarështrimi i gjahut
    - 5.2.8 Objektiva të veçanta për funksionin prodhues
    - 5.2.9 Objektiva të veçanta për funksionin mbrojtës
    - 5.2.10 Objektiva të veçanta për mundësinë e shfrytëzimit
- 6 MASAT PËR MBARËSHTRIMIN E PYLLIT
  - 6.1 Mundësia vjetore e shfrytëzimit
    - 6.1.1 Mundësia vjetore silvikulturale
    - 6.1.2 Metodatat e llogaritjes dhe arsyet për zgjedhjen e prerjes vjetore
    - 6.1.3 Vlerësimi i pasojave të realizimit
    - 6.1.4 Vlerësimi mjedisor
    - 6.1.5 Prerjet e lejueshme përfundimtare
  - 6.2 Masat për shfrytëzim
  - 6.3 Masat silvikulturale
    - 6.3.1 Përgatitja e tokës
    - 6.3.2 Pyllëzimet
    - 6.3.3 Kujdesimet
    - 6.3.4 Rrallimet
    - 6.3.5 Prerje përfundimtare

- 6.4 Masat silvikulturale në cungishte dhe shkurre
- 6.5 Përmirësimi i kullotave
- 6.6 Masat për biodiversitetin
- 6.7 Gjëndja shëndetësore e pyllit /prerjet ilegale
- 6.8 Mbarështrimi i gjahut
- 6.9 Masa specifike për pyjet me funksion prodhues.
- 6.10 Masat specifike për pyjet me funksion mbrojtës
- 6.11 Masat specifike për pyjet e mbrojtur
- 6.12 Masat specifike për pyjet me funksion rekreativ
- 7 **GJËNDJA DHE MASAT PËR INFRASTRUKTURËN**
- 7.1 Përdorëshmëria e infrastrukturës
- 7.1.1 Gjëndja
- 7.1.2 Objektivat dhe masat
- 7.2 Transporti
- 7.2.1 Gjëndja
- 7.2.2 Objektivat dhe masat
- 7.3 Infrastruktura të ndryshme
- 7.4 Infrastruktura për rekreacion
- 7.5 Infrastruktura mbrojtëse
- 7.5.1 Gjendja
- 7.5.2 Objektivat dhe masat
- 7.6 Infrastruktura për mbrojtjen nga zjarri
- 7.6.1 Gjendja
- 7.6.2 Objektivat dhe masat
- 7.7 Infrastruktura të tjera
- 7.7.1 Gjendja
- 7.7.2 Objektivat dhe masat
- 7.8 Vlerësimi mjedisor i ndikimeve nëse është e nevojshme
- 8 **PLANIFIKIMI EKONOMIK**
- 8.1 Volumi i punës dhe kapaciteti
- 8.2 Prashikimi i të ardhurave
- 8.2.1 Parashikimi i kostos
- 8.2.2 Parashikimi i fitimit ose humbjes (përfitime-shpenzime)
- 8.2.3 Vlerësimi i efekteve pozitive të pyllit të pa llogaritshme në vlerë
- 9 **INDIKATORËT PËR MONITORIM DHE VLERËSIM**
- 9.1 Indikatorët afat shkurtër
- 9.2 Indikatorët afat mesëm
- 9.3 Indikatorët për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyllit
- 10 **UDHËZIME PËR REVIZIONIMIN E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT**
- 11 **PLANI 10 VJEÇAR I PUNIMEVE TE PROPOZUARA SIPAS KATEGORIVE TE PUNIMEVE**

## **6. METODOLOGJIA**

Metodika për studimin e hartimin e planit të menaxhimit do të përfshijë punën përgatitore, punë në terren, grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave, hartimin draftit të planit të menaxhimit të pyjeve e kullotave.

Puna përgatitore do të përfshijë:

- Grumbullim informacioni nga dokumentat e mëprashme për punimet e kryera
- Grumbullim materialesh që lidhen me ekonominë pyjore (harta, fotografi ajrore etj.)
- Grumbullim të dhënash nga planet e vjetra të mbarështimit
- Përgatitje paraprake të hartave të ekonomisë pyjore me ndarjen parcelare dhe ndërtimin e rrjetit kuadratik për sipërfaqet provë.
- Rikonicion në terren për vlerësimin e situatës dhe grumbullimin e të dhënave.

Puna përgatitore duhet të bëhet në kohën e duhur, para fillimit të punës në terren grupi i mbarështimit duhet të sigurojë të gjitha materialet e nevojshme që lidhen me ekonominë pyjore që do të mbarështrohet si : hartat, fotografitë ajrore, (në janë të disponueshme), te dhenat e vjetra të planeve të mbarështimit, studime pedologjike, gjeologjike, etj. DSHP janë të detyruar tu sigurojnë mbarështuesve të gjithë informacionin e që ato disponojnë rreth ekonomisë që mbarështrohet. Është një avantazh përpunën në terren që kufijtë e ekonomive pyjore dhe ngastrave të jenë të dukshme dhe të mirëmbajtura. Strukturat e Shërbimit Pyjor në bashki në bashkëpunim me palët e interesuar (pushteti dhe popullatat lokale, OJQ-te, subjektet private etj.) që veprojnë në këtë ekonomi duhet të evidentojë problemet dhe ndryshimet e rëndësishme të gjendjes së pyllit nga e kaluara dhe të hartojnë objektivat kryesore të mbarështimit për të ardhmen.

## **7. INVENTARIZIMI**

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e planit të mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të pyjeve për inventarizimin e ekonomive pyjore me sipërfaqe prove të perhereshme dhe të perkoheshme e përshkrimin parcelar, miratuar nga keshilli shkencor të ish Institutit të kërkimeve pyjore dhe Kullotave, **Nr 1 date 28.3.2001**

## **8. METODA E PUNES PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT**

Metoda e punës për hartimin e planit të mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të pyjeve për inventarizimin e ekonomive pyjore me sipërfaqe prove të perhereshme dhe të perkoheshme e përshkrimin parcelar, miratuar nga keshilli shkencor të ish Institutit të kërkimeve pyjore dhe Kullotave, **Nr 1 date 28.3.2001**

## **9. PROCEDURAT E PUNIMEVE TË TERRENIT**

Në fillim të punës në terren, personat përgjegjës për hartimin e planit të mbarështimit (inspektorët e zonë, specialistët e planit të mbarështimit, dhe shefi i sektorit të menaxhimit) bëjnë një udhëtim të përbashkët në terren për të vlerësuar gjendjen aktuale të pyllit dhe për të përcaktuar objektivat kryesore për mbarështimin e ardhshëm.

Gjatë punës në terren janë të domosdoshme si :

- Kontrolli periodik i punës nga personi i ngarkuar me këtë detyrë, ashtu edhe
- Udhëtimet e përbashkëta e të gjithë personave të interesuar

Në raste kur shfaqen mendime të ndryshme për çështje të caktuara vendimi përfundimtar i takon shefit të sektorit të menaxhimit në DSHP përkatëse.

Në përfundim të punimeve të terrenit kryhet përsëri një kontroll i punimeve nga një grup i përbashkët i personave të interesuar. Problemet kryesore diskutohen dhe rezultatet kryesore paraqiten dhe diskutohen si dhe hidhen bazat e projektit të ardhshëm të mbarështimit.

## **10. PËRGATITJA E DRAFTIT TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT**

Pasi të përpunohen të dhënat në terren dhe informacioni i marrë, do të hartohet drafti i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore bazuar në kriteret sociale ekonomike dhe teknike.

Në kriteret e përfshihen :

- Mjedisi social ekonomik (përdorimi i territorit pyjor dhe zhvillimi i tij, dokumentacioni aktual i tij, traditat të pashkruara, zhvillimi i konditave të vegjetacionit, planifikimi silvopastorial i mëparshëm, të drejtat e përdorimit, zakonet e traditat në mbarështrimin dhe përdorimin e pyjeve dhe kullotave, aspekte të përdoruesve të pyjeve, përshkrimi dhe analiza social-ekonomike e Bashkisë (njësisë Administrative) dhe në veçanti marrdheniet pyje-kullota-bujqësi, vlerësimi kritik i nevojave të popullatës.
- Mjedisi ekologjik (shtrirja, kufijtë, pozita gjeografike dhe topografike), morfologjia e territorit (relievi, lartësia mbi nivelin e detit, kundrejtimi dhe pjerrësia), hidrografia (erozioni, në thellësi e sipërfaqësor, lëvizja e shkëmbinjve, rreshqitja e tokës), temperaturat vjetore, stinore e mujore reshjet, shtresat e borës, kohëzgjatja dhe trashësia, erërat, shkëmbi amnor, karakteristikat e tij shpërndarja sipas territorit me hartografinë përkatëse, tipet e tokës dhe karakteristikat e tyre.

### **11. MBARËSHTRIMI I PYJEVE DUHET TË MBAJË PARASYSH**

- Rendesinë social-ekonomike veçanërisht në zonat rurale
- Nje maksimum stabiliteti dhe fleksibiliteti të grumbujve
- Një përmbushje optimale dhe të qëndrueshme të të gjitha funksioneve
- Sisteme silvikulturale dhe shfrytëzimi në përshtatje me mjedisin lokal dhe karakteristikate grumbullit
- Një aktivitet silvikultural dhe shpeshhtësi ndërhyrjesh në përshtatje me objektivat e mbarështrimit ,kushtet stacionit dhe cilësinë e grumbullit
- Parimet ekonomike,principet e ekonomisë ,pronësisë
- Përdorimin e zhvillimin natyral të pyjeve (automatizimi biologjik)
- Nxitjen dhe përmirsimin e biodiversitetit, veçanërisht llojeve dhe variateteve gjenetike.

### **12. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I PYJEVE DUHET PËRMIRSUAR NËPËRMJET :**

- Një mbarështrimi silvo-pastoral (duke restauruar formën e përdorimit, duke intensifikuar agropylltarinë, rregullimin e kullotave, të drejtën e sigurimit të bazës ushqimore dhe ujitjes, transferimin e të drejtave në Njësi Administrative)
- Rritjes së përfshirjes së komuniteteve lokale
- Pakësimit të prerjeve të paligjshme
- Bashkëpunimit me përdoruesit lokalë dh publik
- Trajnimit dhe ndërgjegjësimin të njerëzve mbi kuptimin dhe rëndësinë e mbarështrimit të qëndrueshëm

### **13. STAFI DHE EKSPERIENCA .**

Stafi i punës për rihartimin e planit të mbarështrimit, duhet të ketë eksperiencë në fushat respektive me drejtues teknik me certificate Shërbime profesionale për projekte/zbatime (preferencë në mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave) .

Grupi i punës përgjithësisht, duhet të përbëhet nga specialiste :

- Inxhinjer pyjesh, i cili është edhe kryetar i grupit .
- Specialist pyjesh (Inxhinier ose teknik)
- Topograf
- Pedolog
- Biolog
- Specialist i të Ushqyerit të blegtorisë



**B. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që janë transferuar në pronësi të Bashkisë Vorë**  
**Qarku Tiranë**  
**Bashkia Vorë**

<b>Nr</b>	<b>Kodi Kadastral</b>	<b>Ekonomia Pyjore/Kullosore</b>	<b>Ngastra/Nëngastra</b>	<b>Sipërfaqja Ha</b>	<b>Kategoria e përdorimit të territorit</b>	<b>Shënime</b>
1	TR36 01040a	EP Vorë	040a	5.75	pyll	
2	TR36 01041b	EP Vorë	041b	11.72	pyll	
3	TR36 02058a	EP Vorë	058a	0.75	pyll	
4	TR36 02058b	EP Vorë	058b	1.00	pyll	
5	TR36 01002a	EP Vorë	002a	3.50	pyll	
6	TR36 01003a	EP Vorë	003a	7.00	pyll	
7	TR36 01016a	EP Vorë	016a	15.25	pyll	
8	TR36 01017a	EP Vorë	017a	18.75	pyll	
9	TR36 01018a	EP Vorë	018a	42.00	pyll	
10	TR36 01019a	EP Vorë	019a	43.75	pyll	
11	TR36 01024a	EP Vorë	024a	26.75	pyll	
12	TR36 01025a	EP Vorë	025a	4.50	pyll	
13	TR36 01026a	EP Vorë	026a	3.50	pyll	
14	TR36 01027a	EP Vorë	027a	5.00	pyll	
15	TR36 01028a	EP Vorë	028a	9.75	pyll	
16	TR36 01029a	EP Vorë	029a	4.00	pyll	
17	TR36 01029b	EP Vorë	029b	16.25	pyll	
18	TR36 01029c	EP Vorë	029c	20.75	inproduktive	
19	TR36 01030a	EP Vorë	030a	13.75	pyll	
20	TR36 01030b	EP Vorë	030b	9.50	pyll	
21	TR36 01031a	EP Vorë	031a	24.20	pyll	
22	TR36 01032c	EP Vorë	032c	18.45	djerr	
23	TR36 01032d	EP Vorë	032d	12.80	pyll	
24	TR36 01036a	EP Vorë	036a	2.40	pyll	

25	TR36 01036b	EP Vorë	036b	6.19	pyll	
26	TR36 01036c	EP Vorë	036c	6.56	pyll	
27	TR36 01036d	EP Vorë	036d	4.87	pyll	
28	TR36 01036e	EP Vorë	036e	5.39	pyll	
29	TR36 01036f	EP Vorë	036f	2.93	pyll	
30	TR36 01041a	EP Vorë	041a	15.10	pyll	
31	TR05 00003	EK Kashar - Prezë	3	69.00	kullotë/livadh	
32	TR05 00004	EK Kashar - Prezë	4	11.00	kullotë/livadh	
33	TR05 00005	EK Kashar - Prezë	5	26.00	kullotë/livadh	
34	TR05 00006	EK Kashar - Prezë	6	34.00	kullotë/livadh	
35	TR05 00007	EK Kashar - Prezë	7	31.50	kullotë/livadh	
36	TR36 01024c	EP Vorë	024c	4.50	ujore	
37	TR36 01024c	EP Vorë	027c	4.00	ujore	
38	TR36 01006a	EP Vorë	006a	21.00	pyll	
39	TR36 01007a	EP Vorë	007a	13.55	pyll	
40	TR36 01008a	EP Vorë	008a	25.00	pyll	
41	TR36 01009a	EP Vorë	009a	24.75	pyll	
42	TR36 01010a	EP Vorë	010a	8.75	pyll	
43	TR36 01011a	EP Vorë	011a	13.75	pyll	
44	TR36 01012a	EP Vorë	012a	23.25	pyll	
45	TR36 01013a	EP Vorë	013a	30.75	pyll	
46	TR36 01014a	EP Vorë	014a	8.00	pyll	
47	TR36 01015a	EP Vorë	015a	6.50	pyll	
48	TR36 01015b	EP Vorë	015b	27.00	pyll	
49	TR36 01020a	EP Vorë	020a	30.25	pyll	
50	TR36 01021a	EP Vorë	021a	26.25	pyll	
51	TR36 01022a	EP Vorë	022a	33.00	pyll	
52	TR36 01022c	EP Vorë	022c	2.25	inproduktive	
53	TR36 01023a	EP Vorë	023a	3.00	pyll	
54	TR36 02022a	EP Vorë	022a	17.50	djerr	
55	TR36 02026a	EP Vorë	026a	13.20	pyll	
56	TR36 02027a	EP Vorë	027a	14.25	pyll	
57	TR36 02028a	EP Vorë	028a	9.25	pyll	

58	TR36 02029a	EP Vorë	029a	15.25	pyll	
59	TR36 02030a	EP Vorë	030a	33.40	pyll	
60	TR36 02031a	EP Vorë	031a	35.50	pyll	
61	TR36 02032a	EP Vorë	032a	19.00	pyll	
62	TR36 02033a	EP Vorë	033a	2.50	pyll	
63	TR36 02034a	EP Vorë	034a	11.00	pyll	
64	TR36 02035a	EP Vorë	035a	42.25	pyll	
65	TR36 02036a	EP Vorë	036a	17.00	pyll	
66	TR36 02037a	EP Vorë	037a	16.75	pyll	
67	TR36 02038a	EP Vorë	038a	34.25	pyll	
68	TR36 02039	EP Vorë	39	27.75	pyll	
69	TR36 02040	EP Vorë	40	19.50	pyll	
70	TR36 02041a	EP Vorë	041a	10.00	pyll	
71	TR36 02042a	EP Vorë	042a	4.75	pyll	
72	TR36 02042b	EP Vorë	042b	4.75	pyll	
73	TR36 02043a	EP Vorë	043a	17.75	pyll	
74	TR36 02044a	EP Vorë	044a	5.25	pyll	
75	TR36 02044b	EP Vorë	044b	14.75	pyll	
76	TR36 02044c	EP Vorë	044c	5.00	inproduktive	
77	TR36 02045a	EP Vorë	045a	41.25	pyll	
78	TR36 02045b	EP Vorë	045b	8.00	inproduktive	
79	TR36 02046a	EP Vorë	046a	17.00	pyll	
80	TR36 02046b	EP Vorë	046b	14.00	pyll	
81	TR36 02046d	EP Vorë	046d	3.50	inproduktive	
82	TR36 02047a	EP Vorë	047a	12.75	pyll	
83	TR36 02048a	EP Vorë	048a	6.00	pyll	
84	TR36 02048b	EP Vorë	048b	11.00	pyll	
85	TR36 01032b	EP Vorë	032b	8.00	pyll	
86	TR36 01033b	EP Vorë	033b	19.50	djerr	
87	TR36 02023a	EP Vorë	023a	3.75	pyll	
88	TR36 02023b	EP Vorë	023b	17.75	djerr	
89	TR36 02024a	EP Vorë	024a	32.75	pyll	

Pregatitën